



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
REKTORATI

Nr. 2244/2 Prot.

Vlorë më, 10.08.2026

VENDIM

Nr. 21, datë 10/08/2026

**PËR SHITESËN E MODULEVE PËR ZHVILLIMIN E SEZONIT TË VERËS PËR
VITIN AKADEMIK 2025–2026**

Në mbështetje të nenit 25 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; nenit 26 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; nenit 15, pika 3, shkronja "c", dhe nenit 87, pikat 10, 11 dhe 13, të Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, si dhe bazuar në shkresat e fakultetit të Ekonomisë, Rektorati, në mbledhjen e datës 20.07.2026,

VENDOSI:

1. Të miratojë shtimin e moduleve për zhvillimin e sezonit të verës, për vitin akademik 2025–2026, sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Lista e moduleve të shtuara, sipas pikës 1 të këtij vendimi, bëhet pjesë përbërëse e listës së moduleve të miratuara me Vendimin e Rektoratit nr. 18, datë 20.07.2026, "Për miratimin e zhvillimit të sezonit të verës dhe propozimin drejtuar Senatit Akademik të modaliteteve të zhvillimit të tij, për vitin akademik 2025–2026".
3. Për zhvillimin e moduleve të shtuara zbatohen tarifat dhe modalitetet e përcaktuara në Vendimin e Rektoratit nr. 18, datë 20.07.2026.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Zëvendësrektorët, Dekani i Fakultetit të Ekonomisë dhe Drejtoria e Shërbimeve Ndihmësakademike.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR


Prof.Dr. Aurela Saliaj

Konceptoi dhe punoi: Gilberta Selami,
Koordinator e Organeve Kolegjiale të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë





per nendryshje → Rektorat
Bv. Rek. Ahmed
[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I EKONOMISË
DEKANI

Nr. 399 Prot.

Vlorë më, 31.07.2026

Lënda: Përcjellje e kërkesave të studentëve

PROF. DR. AURELA SALIAJ
REKTOR
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI", VLORE

Bazuar në kërkesat e studenteve Leart Dano, me nr.374 Prot., datë 10.07.2026, të përcjellë për zbatim nga Drejtuesi i Departamentit të Finances dhe Kontabilitetit të Fakultetit të Ekonomisë, Nertila (Yzeiraj) Halilaj me Nr .374/3 date 27.07.2026 si dhe të studenteve Ledina Neki Merkaj dhe Gersi Brahimi mbështetur në e-mailët e Drejtuesëve të Departamenteve si dhe bazuar në Nenin 87 të Rregullores së Përgjithshme të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, përcjelle për miratim të mëtejshëm propozimet për hapjen e kursit 5 javë për këta studente .

DEKANI I FAKULTETIT TË EKONOMISË

PROF. ASOC. FLORIAN MITI

